



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ROSKOVEC  
KESHILLI BASHKIAK

---

VENDIM

NR. 74. DATË 24. 11. 2017

**"PËR HEQJEN E KAFSHËVE BUJQËSORE NGA ZONAT E BANUARA"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Të Ligjit Nr. 10 465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar", neni 78, 79; të VKM nr. 230, datë 20.03.2013 "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore", kreu VIII, pika 10; Ligjit Nr. 9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbejeteve të ngurta" neni 16; të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 10, pika 3, Keshilli i Bashkise,

**VENDOSI:**

1. Largimin e kafshëve dhe të objekteve bujqësore dhe ndihmës funksionale të tyre jashtë zonave urbane në rastet kur mbajnë:
  - më shumë se 2 (dy) krerë gjedhë
  - më shumë se 10 (dhjete) krerë bagëti të imta
  - më shumë se 1 (nje) thundërak
  - më shumë se 1(nje) derr
  - më shumë se 30 (tridhjete) shpendë
2. Për kafshët që do të lejohen sipas kriterit të mësipërm duhet të plotësojnë kushtet për mbrojtjen e mjedisit si edhe administrimin e mbejeteve të lëngshme dhe të ngurta.
3. Të gjithë pronarët që mbarështojnë kafshë shtëpiake sipas Pikës 1 të këtij vendimi duhet ti largojnë ato brenda 30 ditësh nga data e shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Fier.
4. Pas kalimit të afatit 30 ditor do të zbatohet vendosja e gjobave për kundërvajtje administrative, në masën 10 000 (dhjetë mijë lekë).

5. Në rast se kundravajtësi nuk paguan masën e dëmit të vendosur nga organi kompetent, të bëhet prishja e vendstrehimit dhe sekuestrimi i kafshëve shtëpiake.

**KRYETAR**

**Eleni GOGA**

